



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe
Financat

Tiranë, më 18.6.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PPP,
NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
SI AUTORITETI KONTRAKTOR, SHOQËRISË “ANK”, SH.P.K., SI KONCESIONARI,
DHE SHOQËRISË “BARDH KONSTRUKSION”, SH.P.K., SI SHOQËRIA
KONCESIONARE, PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
SEGMENTIT RRUGOR MILOT–BALLDREN”**

• ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 qershor 2019, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot–Balldren”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj z. Ervin Bushati.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- **Baza kushtetuese e projektligjit.**

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 81, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.**

Projektligji është parashikuar në programin analitik të Këshillit të Ministrave për t’u miratuar gjatë vitit 2019, si dhe është pjesë e programit buxhetor afatmesëm. Kontrata e koncesionit parashikon projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një rruge prej rreth 17.3 km, e cila shtrihet përgjatë aksit të rrugës ekzistuese që lidh Milotin me qytetin e Lezhës dhe më pas devijohet si rrugë tërësisht e re, nga Lezha deri në Balldren, ku më pas lidhet me rrugën ekzistuese në drejtim të Shkodrës. Projekti parashikon ndërtimin e segmentit rrugor Milot-Balldren, ndërtimin e tunelit në Malin e Rencit, si dhe ndërtimin e dy urave: Urës së Matit dhe Urës së Drinit. Gjithashtu, ai parashikon ndërtimin e 9.5 km rrugë dytësore dhe rrugë lidhëse të nyjeve, për të mundësuar dhe lehtësuar qarkullimin e banorëve të zonës.

Aksi rrugor dhe tuneli janë parashikuar të ndërtohen sipas standardit “kategoria A”. Tuneli do të ndërtohet me dy tuba, ku përfshihen edhe portalet në hyrje dhe dalje për tubat, sipas standardeve shqiptare dhe normativave europiane të përditësuara për ndërtimin e tuneleve.

Projekti është paraqitur në formën e propozimit të pakërkuar dhe është mbështetur nga komisioni i dhënies me koncesion/PPP në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr. 634, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të ndryshuar. Komisioni bëri analizën e rentabilitetit, fizibilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare të projektit, duke vendosur dhënien e bonusit shoqërisë që ka paraqitur propozimin.

Projekti mundëson zbatimin e parimit të shpërndarjes efektive të riskut, pasi koncesionari merr përsipër pjesën më të madhe të risqeve. Kontrata merr përsipër ndërtimin, mirëmbajtjen dhe operimin e veprës me cilësi dhe standard të lartë. Pagesat për palën private kanë si kusht cilësinë e shërbimit të ofruar.

Kohëzgjatja e projektit është parashikuar për 13 vjet, nga të cilat rreth 5 vjet është faza e ndërtimit dhe 8 vjet faza e mirëmbajtjes.

Kostoja totale e projektit është rreth 213.7 milionë euro plus TVSH-në. Kjo kosto do të përballohet nga burimet si më poshtë:

- 70 milionë euro hua bankare;
- 52 milionë euro investim i shoqërisë;
- 19.5 milionë euro financim nga furnitorët;
- Diferenca (72.2 milion euro) nga buxheti i shtetit.

Norma e interesit për të gjitha burimet e financimit është 5 për qind.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatori paraqiti projektligjin, duke u ndalur në thelbin e kontratës së koncesionit, si dhe impaktin që ajo pritet të ketë në zhvillimin ekonomik të zonës dhe të ekonomisë në tërësi.

Propozuesit e projektligjit paraqitën një informacion të detajuar për kontratën e koncesionit, në përgjigje të pyetjeve të deputetëve. Ata theksuan se çmimet e referuara në kontratë janë në përputhje me çmimet e manualeve që përdor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjatë diskutimit, deputetët e mazhorancës theksuan se aksi rrugor Milot-Balldren është një nga segmentet më të rëndësishëm të konektivitetit si brenda vendit, ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor. Ndërtimi i këtij aksi do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, lehtësimin e trafikut, mundësimin dhe lehtësimin e qarkullimit të banorëve të zonës, zhvillimin e turizmit, reduktimin e rrezikut gjatë qarkullimit të mjeteve dhe udhëtarëve. Si rrjedhojë, ai do të sjellë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të kësaj zone me potencial të veçantë, si dhe të ekonomisë së vendit në tërësi. Procedura e propozimit të pakërkuar, e përdorur në këtë kontratë, krijon mundësi për kryerjen e investimit dhe përdorimin e tij brenda një periudhe të shkurtër, ndërkohë që pagesat nga buxheti i shtetit bëhen pjesë-pjesë ndër vite. Kjo procedurë përdoret në shumë vende të botës për ndërtimin e veprave të infrastrukturës rrugore, portuale etj. Aksi rrugor do të ndërtohet me parametra të lartë cilësorë, gjë që ka ndikim në koston e projektit, ndërkohë që çmimet e përdorura në kontratë janë në përputhje me manualët përkatëse.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan kontratën e koncesionit/PPP për këtë segment rrugor, duke pretenduar se kostoja e projektit është e lartë dhe rëndon buxhetin e shtetit.

Komisioni kërkon që strukturat përgjegjëse ekzekutive të monitorojnë me rigorozitet zbatimin e kontratës së koncesionit/PPP, për të mundësuar ndërtimin e një segmenti rrugor me parametra cilësorë të lartë dhe për të siguruar mirëmbajtjen e vazhdueshme të tij, në përputhje me kontratën. Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të ndjekë vazhdimisht koston e projektit, për të siguruar zbatimin e treguesve të parashikuar në kontratë dhe në ligjin e buxhetit, duke ndikuar në vijimin e qëndrueshmërisë së financave publike. Gjithashtu, Komisioni kërkon rritjen e transparencës ndaj publikut në drejtim të informimit për koston e projektit, si dhe detaje të tjera

të tij.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicë votash.

RELATORI

Ervin BUSHATI

KRYETARI

Arben AHMETAJ